

VENDIM
Nr.533, datë 16.7.2004

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2004, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR FINANCIMIN E KONFERENCËS VJETORE TË SHOQATËS SË ZYRTARËVE ZGJEDHORË TË EUROPËS LINDORE DHE QENDRORE (ACEEEO)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të neneve 7 e 10 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2004, t'i shtohet fondi prej 6 908 440 (gjashtë milionë e nëntëqind e tetë mijë e katërqind e dyzet) lekësh, për financimin e konferencës vjetore të Shoqatës së Zyrtarëve Zgjedhorë të Europës Lindore dhe Qendrore (ACEEEO), që do të zhvillohet në Tiranë më datat 9-11 shtator 2004.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Financave dhe kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano